



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Shkathtësi Akademike dhe Biznesore EKB0007

Data e aprovimit:	Data
Verzioni:	Verzion
ECTS:	6
Bartësi i lëndës:	Bardha Qirezi
Email:	bardha.qirezi@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322

Hyrje:

Mirë se vini në lëndën Shkathtësi Akademike dhe Biznesore e cila ju ofron një program angazhues ku do të kërkohet nga ju të menaxhoni kohën e juaj me kujdes për të arritur sukses.

Qëllimet

Kjo lëndë ka për qëllim të përgatis studentët për realizimin e detyrave themelore gjatë studimeve dhe në punë. Lënda përfshin temat: Auditimin e shkathtësive personale , menaxhimin e kohës, shkrimin akademik, shkresat zyrtare , prezantimin, punën grupore dhe shkathtësitë esenciale në IT që i mundësojnë studentit të jetë efektiv gjatë studimeve dhe në punë.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Të komunikojë zyrtarisht kërkesat dhe ankesat elementare me shkrim
- Të kuptojë rëndësinë dhe teknikat e menaxhimit të kohës dhe të përgatis portfolion e punimeve
Të shkruaj dhe të prezantoj në mënyrë efektive për audiencë akademike duke përdorur gjuhën e shkruar letrare dhe të menduarit kritik individualisht dhe në grup.
- Te përdorë aplikacionet Word , Excell, Power Point, Prezi dhe Publisher për të prezantuar ese, letra ,raporte me shkrim dhe me gojë
- Të kërkoj dhe të përdor literaturën fizike dhe elektronike në bibliotekë dhe internet për qëllime
- studimi dhe të përdor format korrekte të referencimit për të evituar plagjiarizmin

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Shkathtësitë Akademike dhe Menaxhimi i Kohës	Njohja me Syllabusin. Planfikimi i orarit, caktimi i prioriteteve dhe portfolio. Detyra: 1. Jam qasur në shërbime;2. Ku shkon Koha; 3. Inkuadrimi i orarit në Telefon, kalendar.

2	Burimet në bibliotekë dhe përdorimi i tyre	Kërkimi në internet, Plagjiatura dhe Referencimi(bazike). Portfolio: 1. Testi i Plagjiaturës; 2. Parafrazimi.
3	Si të përgatitet një punim	Si të përgatitet një punim. Struktura, titujt, nentitujt, tabelat, figurat. Portfolio: Modeli i Punimit
4	Shkrimi i eseut	Planifikimi, Identifikimi i temës, Fokusimi nga ideja deri te tema, Identifikimi i pyetjes së eseut, Struktura e eseut Zhvillimi i qëndrueshëm-Shih lidhjet. Brainstorming per ide per punimin dhe prezantimin.Portfolio: Definicioni i Zhvillimit të Qëndrueshëm.
5	Shkrimi Akademik	"Paragrafi, Fjalja efektive, Rrjedha logjike e mendimeve dhe koherenca në paragraf, Përshkrimi, Struktura e paragrafit, Parafrazimi
6	Argumentimi	"Argumentimi dhe koherenca, çka janë argumentet?, Si të dallojmë argumentet nga përshkrimet dhe llojet e tjera të fjalive?, Si të dallojmë argumentet false?, Si të argumentojmë?, Si të parashtrijmë dhe të arsyetojmë argumentin?, Si të përdorim parafrazimin për të argumentuar? Debati sipas Karl Poper.
7	Shkrimi Akademik	Eseu përshkruar, Hyrja, Trupi, Konkluzioni. Shembull: Përshkrimi i profilit të kompanisë.
8	Shkrimi Akademik	Eseu krahasues, Tipet e eseut krahasues, Hyrja, Trupi, Konkluzioni.Grupi; Ushtrimi grupor: Debati me ekipe për dhe Kundër.
9	Shkrimi Akademik	Eseu argumentues, Mënyrat e argumentimit, Hyrja, Trupi, Konkluzioni. Tema për punimin përfundimtar dhe prezantimet.
10	Përdorimi i IT së për organizim dhe prezantimin e informatave	Krijimi i tabelave, Renditja dhe integrimi, Krijimi i figurave prej tabelave, Integrimi, Krijimi i një broshure apo posteri me publisher
11	Puna grupore	Dorëzimi i detyrës: Shpjegimi i detyrës, Prezantimi Grupor
12	Si të prezantojmë?	Të shkruarit për prezantim, Teknikat dhe llojet e prezantimit, Kombinimi i prezantimit oral dhe të shkruar, Atributet e një folësi efektiv
13	Përgatitja e prezantimeve	Njohja me power point. Ushtrime për përgatitjen e prezantimit, Paraqitja e punimit në prezantim
14	Shkresat zyrtare	Aplikacioni, Kërkesa/Ankesa, Komunikimi me e-mail
15	Prezantimet e studentëve	Prezantimet e studentëve/Vlerësimi

Informata shtesë 1:

Lënda është praktike. Të gjitha ushtrimet kryhen në klasë. Studentët duhet të kenë kujdes që detyrat që u jepen në klasë dhe për detyrë shtëpie t'i kryejnë me rregull dhe që t'i përmbledhin të gjitha në kuadër të portfolios së tyre.

Informata shtesë 2:

Shpresojme se kjo lëndë do të jetë e këndshme, sfiduese dhe inspiruese. Mbi të gjitha kjo lëndë është dizajnuar për ju dhe për adaptimin tuaj në jetën akademike dhe biznesore prandaj dhe sa më shumë që angazhoheni aq më shumë do të përfitoni.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji Vleresimit	Perqindja	Pershkrimi
-----	------------------	-----------	------------

1	Detyra	30	Ju do të notoheni në mënyrë të vazhdueshme në bazë të materialeve të dorëzuara në portfolio. Gjithçka që punohet në klasë duhet të dorëzohet në formë të portfolios.
2	Ese	40	Ju do të shkruani një ese 500 fjalë të cilin do ta dorëzoni në javën e 11 të mësimit. Detyra do të jepet nga mësime të mëparshme.
3	Prezentim	30	Ju do të merrni pjesë në debatin sipas strukturës së Karl Poper në temën e caktuar paraprakisht. Debat i organizohet në javën e 15 të mësimit.

Kushtet e përsëritjes:

Nuk ka provim për këtë lëndë. Elementet e vlerësimit duhet të përsëriten për të kaluar lëndën.

Burimet:

- DANAJ, S (Ed). 2012. Shkrimi Akademik. Tiranë: Instituti i Studimeve Politike. (Përkthim nga PONE, S, BARNET, S, BELLANCA, P., STUBBS, M. Barnet, S.) Bellanca, P. Stubbs, M. (2012). A short Guide to College Writing. Longman Publishing Group.

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	2	
Ushtrime:	1	
L+U:	45	
Seminar/praktike.:	30	
Studim i vazhdueshem:	30	
Pregaditja e Provimit:	30	
Pjesemarrja ne teste:	0	
Pjesemarrja ne provimin final:	0	
Me profesorin dhe asistentin:	15	
Total Ore:	150	
ECTS:	6	